



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:183132

Datë: 16.02.2023

Numri i dokumentit: 03985004

APS.nr.49/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – DEPARTAMENTI SPECIAL, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Burim Ademi – kryetar, Vaton Durguti dhe Ferit Osmani – anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, në lëndën penale ndaj të akuzuarit S.B, për shkak të veprës penale Krime lufte kundër popullatës civile nga neni 142 të LP të RSFJ-së, si ligj në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, aktualisht e ndëshkueshme sipas veprës penale Krime lufte në shkelje të rëndë të nenit 3 par. 1 shkronja/b/ dhe /c/ të përbashkët për Konventat e Gjenevës, të dt. 13 gusht 1949 dhe nenit 4 par. 2 shkronja /c/ dhe /e/ të Protokolit II, aktualisht i ndëshkueshëm edhe nga neni 146 të KPRK-së (Nr.06/L-074), duke vendosur lidhur me ankesën dhe përgjigjen në ankesë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, ankesën dhe përgjigjen në ankesë të mbrojtësit të akuzuarit S.B, av.Dejan Vasic si dhe ankesën e të akuzuarit S.B, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PS.nr.49/2022 i datës 08.09.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.01.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës Kosovës, ankesa e të akuzuarit S.B si dhe e mbrojtësit të tij avokatit Dejan Vasic, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, PS.nr.49/2022 i datës 08.09.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, me aktgjykimin PS.nr.49/2022 të datës 08.09.2022, të akuzuarin S.B e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Krime lufte kundër popullatës civile nga neni 142 të LP të RSFJ-së, si ligj në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, aktualisht e ndëshkueshme sipas veprës penale Krime lufte në shkelje të rëndë të nenit 3 par. 1 shkronja/b/ dhe /c/ të përbashkët për Konventat e Gjenevës, të dt. 13 gusht 1949 dhe nenit 4 par. 2 shkronja /c/ dhe /e/ të Protokolit II, aktualisht i ndëshkueshëm edhe nga neni 146 të KPRK-së (Nr.06/L-074) dhe e ka gjykuar me dënim me dërgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e qëndrimit në paraburgim nga dt.22.12.2020 e deri sa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Është obliguar i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 100€, si dhe në emër të fondit të viktimave të krimit shumë prej 50€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

Meqë të akuzuarit gjykata në rastin konkret i ka shqiptuar dënimin me burg në kohëzgjatje 5 (pesë) vite, konform nenit 367 par.2 të KPPRK-së, të njëjtit me aktvendim të posaçëm i ka vazhduar masën e paraburgimit deri në plotfuqishmëri të këtij aktgjykimi.

Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike i ka udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë kanë ushtruar:

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal nga neni 383 par.1 nënpar.1.4 lidhur me nenin 387 par.1 të KPRK-së, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar ashtu që të akuzuarit në pjesën që ka të bëjë me lartësinë e dënimit ti shqiptoj dënim me të lartë, në proporcion me peshën e veprës penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit S.B, av.Dejan Vasic, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga 384 par.1 pika 1.8, 1.10 dhe 1.12, par.2 pika 2.1 dhe 2.2 lidhur me nenin 1 pika 2, neni 2 dhe 7 të KPPRK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes

faktike nga neni 386 par.1 dhe 2 të KPPRK-së dhe shkeljes së ligjit penal nga neni 385 të KPPRK-së, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoi ankesën, ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar, ashtu që të akuzuarin ta liroj në mungesë të provave apo lëndën ta kthej në rigjykim dhe rivendosje.

I akuzuari S.B, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga 384 par.1 pika 1.8, 1.10 dhe 1.12, neni 2 pika 2.1 dhe 2.2 konkretisht neni 1 pika 2, neni 2 dhe 7 të KPPRK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 386 par.1 dhe 2 të KPRK-së dhe shkeljes së ligjit penal nga neni 385 të KPRK-së, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, në bazë të nenit 398 par.1 pika 1.4 ta aprovoi ankesën, ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar, ashtu që të akuzuarin ta liroj në mungesë të provave.

Përgjigje në ankesën e mbrojtësit e të akuzuarit S.B, av.Dejan Vasic, ka ushtruar prokurori i Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës, me propozim që ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit të hudhet si e pa bazuar.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës ka ushtruar mbrojtësi i të të akuzuarit S.B, av.Dejan Vasic, me propozim që ankesa e Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës, të refuzohet si e pa bazuar.

Prokurori i Apelit më parashtrës, PPA/I.nr.632/2022, datë 15.12.2022 dhe 21.12.2022, ka propozuar që të aprovohet ankesa dhe përgjigjja në ankese e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës si të bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet sa i përket vendimit mbi dënim dhe të akuzuarit ti shqiptohet një dënim me i lartë se sa në aktgjykim e ankimuar, kurse ankesa dhe përgjigjja në ankesë e mbrojtësit të akuzuarit S.B-av.Dejan Vasic si dhe ankesa e të akuzuarit S.B të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPRK-se në të cilën kanë marrë pjesë, i akuzuarit S.B dhe mbrojtësi i tij av.Dejan Vasic, kurse nuk ishte i pranishëm Prokurori i Prokurorisë së Apelit dhe e dëmtuara T.K edhe pse janë njoftuar në mënyrë të rregullt. Mbrojtësi i të akuzuarit elaboroj ankesën theksoj se mbetet në tërësi pran pretendimeve ankimore të paraqitura me shkrim, si edhe me sqarim me shkrim të paraqitur kësaj gjykate më dt.19.01.2023, ndërsa i akuzuari S.B, ka theksuar se nuk është fajtor dhe nuk e ka lënduar askënd, se është i pafajshëm, dhe se në një pjese të procedurës kam qenë i liruar nga

paraburgimi pastaj jam kthyer në Serbi, mirëpo për seancën e radhës jam paraqitur pa asnjë mëdyshje pasi që unë kam shpirtë të pastër dhe e di që askënd nuk e kam lënduar, jam i pastër para zotit, nuk kam qenë asnjëherë anëtar i ushtrisë dhe policisë dhe nuk kam mbajtur asnjëherë uniformë e sa armë.

Gjykata e Apelit, analizoi aktgjykimin e ankimuar së bashku me shkresat e lëndës, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet ankimore të Prokurorisë, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij si dhe përgjigjet në ankesat e ushtruara dhe gjeti se:

Ankesat nuk janë të bazuara.

Në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës Kosovës, theksohet se për kundër faktit se vepra penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor është mjaft e rëndë për faktin se një e mirë juridike e mbrojtur me sistem juridik ishte rrezikuar dhe dëmtuar nga veprimet e të akuzuarit, gjykata e shkallës së parë në rastin e matjes dhe caktimit të dënimit nuk i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë rrethanat rënduese në rastin e shqiptimit të dënimit, siç janë shkalla e lartë e rrezikshmërisë se veprës penale, pasi që i akuzuari kishte hyrë i armatosur në shtëpinë e të dëmtuarve, faktin se viktimat ishin në moshë të shtyrë dhe posaçërisht të pa mbrojtur, motivin e ulët për të poshtëruar të dëmtuarën T.K duke e detyruar të qëndroj mbështetur për muri tek shitorja në qendër të fshatit nën kërcënimin e armës. Sipas prokurorisë sot e dëmtuara është gjallë jo për shkak të ndonjë sjellje veprim vullnetar të të akuzuarit por si rezultat i ndërhyrjes së dëshmitarit-fqinjtit M.S i cili ishte përleshur me të akuzuarin dhe kishte arritur ta shpëtoj të dëmtuarën, ka shtuar se nga ky rast e dëmtuara ka pasur përjetime shumë të rënda emocionale dhe frikë të intensitetit të lartë e cila e përcjell edhe sot e kësaj dite. Për kundër të lartcekurave gjykata ka marrë si rrethanë personale lehtësuese se i njëjti kishte paraqitje korrekte në gjykatë apo se i njëjti ka mbajtur premtimin se do të paraqitet në gjykatë, mirëpo këtë rrethana nuk janë fare në listën e rrethanave të përcaktuara në nenin 41 të LP të RSFJ-së të cilat duhen të merren parasysh në rastin e marrjes se dënimit. Tutej ka shtuar se dënimi i shqiptuar nuk është i drejtë dhe në proporcion me veprën e kryer për shkak se rrethanat lehtësuese të pa përcaktuar me ligj kanë ndikuar në matjen-përcaktim e një dënimi aq të butë, kur merret parasysh fakti se maksimumi i dënimit për veprën penale në fjalë është pesëmbëdhjetë vjet, atëherë gjykata e shkallës së parë gabimisht ka interpretuar dispozitën e nenit 41 të LP të RSFJ-së dhe për pasoj të akuzuarit i ka shqiptuar dënim shumë të butë dhe jo proporcional me veprën e kryer, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Në ankese mbrojtësi i të akuzuarit S.B, av.Dejan Vasic, ka theksuar se gjykata në aktgjykim e ankimuar nuk është kujdesur fare për provat të cilat janë administruar e as për besueshmërinë e tyre si dhe nuk i ka vlerësuar pretendimet e caktuar.

Sipas mbrojtjes nga përshkrimi lidhur me veprimet e të akuzuarit në periudhën kohore korrik – gushte 1998 të cekura si në dispozitivin e aktgjykimi të ankimuar pjesa se i akuzuari ka gjuajtura nga pushka automatike në drejtim të dritareve dhe kulmit....., dhe të dëmtuarën T. e nxjerre në rrugë ndërsa të dëmtuarit R. i thotë se gurjen do tija qoj në shtab të ushtrisë serbe dhe policisë në mese të fshatit dhe mundet të marr masa të vine UÇK-ja dhe e detyron të dëmtuarën të dal nga shtëpia dhe të hec rrugës se fshatit natën gjate luftës në një vende të pa banuar pa drita, e qon deri të qendra e fshatit, e kthen në shitoren e fshatit dhe në prezencën e të tjerëve e mbështet për muri, ndërsa ai qëndron përballë saj me armë në dorë në një distancë shumë të vogël dhe ndërkohë vjen fqinja e viktimës, dëshmitari M.S, e cili përleshet me të pandehurin duke e goditur me grusht dhe në këtë mënyrë arrin ta kthejë viktimën në shtëpi dhe të nesërmen i largon dy të dëmtuarit (R. dhe T.) nga fsh. Belo Pole, duke u krijuar një mundësi për të shkuar në qytetin e Pejës. Kjo pjesë është tërësisht e shpikur nga prokuroria speciale dhe e shkelur nga gjykata e shkallës së parë pa asnjë mbështetje absolutisht në prova, pjesa e nënvizuar është më se e saktë, pjesën e nënvizuar dhe të guximshme e ka shpikur vetë gjykata, po ashtu në pjesën lidhur me fjalët përfundimtare të prokurorisë dhe mbrojtjes, gjykata është selektive, arbitrare dhe injorante për atë që kemi deklaruar unë dhe prokurori.

Lidhur me pretendimet e prokurorisë ka theksuar se njohja dhe identifikimi i personit të dënuar sipas pozicionit të prokurorisë është i padiskutueshëm dhe bazohet në tezat e mëposhtme: në procedurën hetimore kur është marrë në pyetje e dëmtuara T.K, i akuzuari i është drejtuar asaj duke thënë se “njeriu që të ka shpëtuar është babai im L.”, dhe me këtë pyetje, i akuzuari S. ka dashur vetëm të rifreskojë kujtesën e dëshmitares se nuk ka qenë dëshmitari M.S që e ka shpëtuar atë nga një rrëmbyes i panjohur, por se atë e ka bërë babai i të dyshuarit, i ndjeri L.B.

Në fjalën e tij përfundimtare, prokurori çështjen e identifikimit e konsideron të pa dyshimtë për faktin se i dëmtuari dhe dëshmitari M.S kinse kanë thënë se B. ka qenë ai që është hajdut, nga kjo deklaratë është e paqartë se si mund të thotë prokurori se fakti i prezencës së të akuzuarit S.B është vërtetuar në bazë të asnjë që dëshmitari M.S i ka thënë se ai ishte hajdut, ndërsa e dëmtuara ka deklaruar se ishte njëfarë B. dhe se flitej se ai ishte hajdut, një përfundim i tillë është në kundërshtim nga parimi in dobi pro reo, i përfshirë në nenin 2. KPRK-së, pasi që fakti që një

person është hajdut mund të provohet vetëm dhe ekskluzivisht me një aktgjykim të formës së prerë. Po ashtu prokurori në fjalën përfundimtare thekson se i dëmtuari gjatë procesit të identifikimit nuk ka mundur ta njohë të dënuarin S. në fotografi, me sa duket janë fotografi të reja dhe jo të kohës kur ka ndodhur ngjarja para 20 viteve, lidhur me këtë prokurori i shmanget faktit se e dëmtuara, znj. T. ka deklaruar para trupit gjykues në një rast të veçantë provash më 16.07.2021, kur e ka parë S. drejtpërdrejt para gjykatës se nuk është ky personi që e mori nga burri i saj R. dhe se ajo nuk e njeh fare S., kurse për dëshmitarin M.S, prokurori special ka thënë se i beson atij pasi sepse nuk ka motive personale për të akuzuarin S., ndërsa më tej thekson se kushdo që ka qenë në sallën e gjyqit gjatë marrjes në pyetje të këtij dëshmitari ka parë se sa urrejtje personale kishte ky dëshmitar ndaj personit të dënuar, në fund të fundit, kjo është shënuar në procesverbal kur ai i është drejtuar të dënuarit me fjalët se njerëzit si ai duhet të vriten, kurse lidhur me besueshmërisë së dëshmitarëve nuk është marrë as prokurori e as gjykata.

Kurse sa i përket interpretimit të fjalës sime përfundimtare të përfshirë në aktgjykim, me të drejtë pyes veten nëse është e mundur që fjalët e mia, të cilat gjenden me shkrim në shkresat e lëndës, mund të interpretohen lirisht në këtë mënyrë, prandaj lidhur me këtë kërkoj nga Gjykata e Apelit që të përdorë fjalën time përfundimtare dhe atë që gjykata ka shkruar që kam thënë në fjalën përfundimtare, kështu që do të shihet se në çfarë mase fjalët u shtrembëruan.

Më tej ka theksuar se dy dëshmitarët S.Ç dhe M.S kanë paraqitur falsifikime të rënda para gjykatës, dhe në fjalën përmbyllëse i referova në detajet e mosmarrëveshjet në deklaratat e këtyre dy dëshmitarëve e që i kam vënë në kontrast me deklaratën e të dëmtuarës T.K e cila është e vetmja që mund t'i besohet me siguri 100%, kurse për mendjen e kthjellët të zonjës T. ka dëshmuar djali i saj H.K. Gjykata në vendimin e saj kufizohet vetëm në numrin e deklaratave, pa thënë asnjë fjalë për mosmarrëveshjet e tyre, kur bëhet fjalë për deklaratat e T.K dhe M.V, madje kur është fjala për deklaratën e dëshmitarit M.S, gjykata e shkallës së parë citon vetëm ato pjesë që e inkriminojnë të dënuarin, duke iu shmangur citimit të pjesëve të dëshmisë së këtij dëshmitari në të cilat ai iu përgjigj pyetjes së mbrojtjes, kurse është edhe më drastik kur bëhet fjalë për deklaratat e viktimës T.K, për të cilën as prokuroria dhe as prokuroria nuk deklarojnë se çfarë ka thënë gjatë rastiit të posaçëm të provës, por vetëm deklarojnë fjalët e saj nga procedura hetimore.

Tutje në ankesë mbrojtja thekson se i referohet sërish këtyre mosmarrëveshjeve, duke përshtuar ngjarjen që zonja T. në thelb thotë: Se nuk i ka dëgjuar të shtënat, para shtëpisë se tyre dhe pastaj

se në shtëpinë e tyre ka hyrë një person ku kanë qen ajo T. dhe R. duke kërkuar refugjat, ku pse me arme në dorë e ka nxjerrë T. nga shtëpia dhe e ka qu deri te shitorja, atje një person tjetër (djemtë e B.) e kanë ndalura dhe pas bisedës mes mese veti T. e kanë kthye në shtëpi. Nuk kanë dëgjuar të shtënat se ka marrë vesh në mënyrë të pashpjegueshme që e dëmtuara është rrëmbyer, se e ka gjetur të ndjerin R. me dy vajza që qanin në oborr dhe se ka shkuar në dyqan, e ka rrahur te paarmatosur S. dhe e ktheu T. në shtëpi.

Ashtu që në vend që të krahasojnë këto dy deklarata, me urrejtjen e tmerrshme të M.S ndaj S.B-it në shqyrtimin gjyqësor, ata arritën në përfundimin se ky ishte një dëshmitar jo i besueshëm, dukshëm i njëanshëm, të cilit nuk mund t'i besohet, gjykata e shkallës së parë nuk bën asnjë krahasim fare, as nuk i referohet kësaj pyetjeje. Sikur nuk ka ndodhur kjo, sikur gjithçka që them nuk është regjistruar tashmë në procesverbal. Andaj konsideron se Gjykata e Apelit do të vërë në dukje shkeljen e dispozitave të nenit 370.para.7 KPRK-së, duke i referuar më tej tekstit të kësaj dispozite, prandaj thekson se gjykata e shkallës së parë këtë dispozitë e ka shpërfill plotësisht duke vendosur në pjesën dispozitive të aktgjykimit si fakte të vërtetuara pjesët që i kam theksuar dhe nënvizuar në pjesën hyrëse të kësaj ankese,- se personi që ka hyrë në shtëpinë e familjes R. ka qëlluar në drejtim të çatisë dhe dritares, e cila nuk është askund nga asnjë dëshmitar, - se ky person i ka thënë të dëmtuarit R. se do ta kthejë gruan e tij kur t'i sjellë pjesëtarët e UÇK-së, - se e gjithë kjo ndodh natën, se viktima është marrë përgjatë një rruge rurale, pak të populluar, - se në prani të personave të tjerë mbështete pas murit duke qëndruar përballë saj me armë në dorë, mirëpo me asnjë provë nuk e ka vërtetuar se kjo ka ndodhur, ashtu siç e interpretohet nga prokurori special dhe gjykata e shkallës së parë. Që Gjykata e Apelit të bindet për të vërteten Gjykatës së Apelit, nuk i duhet as gjysmë ore lexim, mjafton të studiohen dy thëniet e T.K në tri thëniet e M.S, pas të cilave laikut do t'i bëhet e qartë se ky është një person që nuk thotë të vërtetën, por thotë të pavërteta, i shtyrë nga urrejtja ndaj të pandehurit. Kësaj duhet t'i shtohen edhe dy deklaratat e dëshmitares S.Ç, e cila thotë se gjithçka që thotë e ka dëgjuar nga M.S, ndërsa M.S gjatë gjykimit pretendon se nuk ka folur fare me S.Ç për ngjarjen.

Më tej thekson se gjykata e shkallës së parë provat kryesore për veprimet inkrimineuse të të akuzuarit i ka vërtetuar nga personat e lënduar, gjegjësisht dëshmitarja T.K si palë e dëmtuar dhe deklaratat e M.S si dëshmitar i cili ka qenë drejtpërdrejtë i përfshirë në ngjarjen e ditës kritike)... e lënduar T.K të cilën nuk ka mundur ta identifikojë përmes fotos, por trupi gjykues vlerëson se është edhe e natyrshme, duke marrë parasysh se kanë kaluar 20 vjet nga ngjarja dhe mosha e të dëmtuarit...., mirëpo ne rastin e citimit të deklaratës së palës së dëmtuar, gjykata shmangu të

shkruante se ajo e tha qartë në seancë për një mundësi të veçantë provash pasi e kishte parë S. drejtpërdrejt - se ai nuk e njeh atë dhe se nuk është ai personi që e ka marrë nga shtëpia, përveç kësaj as prokuroria dhe as policia, nuk i referohen këtyre fjalëve, sikur të mos ishin dëgjuar dhe regjistruar në procesverbal.

Tutje mbrojta i referohet pyetjeve se pse u gjykua i akuzuari, në radhë të parë: për shkak të formularit të plotësuar të dënimit, ndoshta është dashur disi të rregullohet me ligj që të dyshuarit për krime lufte në Kosovë as të mos gjykohen, apo më e mira është që të menjëherë të dënohen, pa këto farsa të gjykimit. S.B nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe këtë e dinë gjyqtarët e shkallës së parë, si prokurori special që ka ngritur aktakuzën. Këtë më së miri e di i dëmtuari, i cili është më i interesuar për të vërtetuar të vërtetën. Së fundi, në ankesë lidhur me rrjedhën e deritanishme të procedurës, shtron pyetjen se kujt i ka besuar gjykata, pasi që e dëmtuara T., ka thënë se S. nuk ishte personi që e kishte marrë nga shtëpia, apo nëse ajo i ka besuar dëshmitaret e rremë S.Ç dhe M.S të cilët pretendojnë se ai është, kësaj pyetjeje do t'i duhej t'i përgjigjej Gjykata e Apelit, duke pasur parasysh se gjykata e shkallës së parë e shmangu. E vetmja gjë që nuk do të doja është që gjykata e Apelit të thotë se provat janë konsistente, dhe mbrojtja e të akuzuarit është e llogaritur për të shmangur përgjegjësinë penale, pa i shpjeguar akuzat e Apelit, siç ka qenë praktika deri tani, për arsye të la cekura ka propozuar si me lartë.

Në ankese i të akuzuari S.B, thekson se nuk kam qene prezentë dhe nuk kam mare pajës në rrëmbimin e të dëmtuarës T.K 1998 e cila është cekur në aktakuzë dhe pas dëshmisë së të dëmtuarës e cila e ka deklarua në gjykate se nuk e njohe është dashur që procedura penale të ndërpritet dhe unë të lirohem, mirëpo gjykata ia ka falur mirëbesimin dëshminë e dëshmitarit M.S i cili pretendon se me ka par si të dëmtuarën e kam rrëmbyer dhe se je e ka shpëtuar dhe e kthyen në shtëpi. Është në kundërshtim me deklaratën e të dëmtuarës, e cila ka deklaruar se nuk e ka një personin i cili e ka rrëmbyer dhe nuk e ka njoh edhe personin i cili e ka shpëtuar. As kund nuk e ka përmendur M.S, për këtë deklaratë e të dëmtuarës, deklarata e M.S u dashtë me hudhe si e pa vërtete, ajo të jetë prova kryesore për një aktgjykim, nuk mundet të jetë ma vlefshme ndonjë deklaratë tjetër se sa deklarata e të dëmtuarës, kur shiftë se M.S ka pasur një motiv për të rrejtur se është në mosmarrëveshje me familjen time. Kjo urrejtje kundër meje ka qenë shumë e theksuar gjate paraqitjes se tij në gjykate. Ka shtuar se nuk e ka të çartë pse dëshmitaret e tjerë prokuroria i ka sjellë në gjykatë pasi që as njeri nuk ka qenë prezent gjatë ngjarjes, ku vetë janë deklaruar por kanë folur do fjale pa lidhje të cilat i kanë dëgjuar dhe këto deklarate dhe dëshmi nga dora e dytë nuk mund ti aprovoj as një gjykatë. Edhe pse kanë qenë

dëshmitar në prokurori kanë deklaruar fjalë pa lidhje, gjykata deklaratave të tyre i ka shtuar fjali të cilat nuk i kanë deklaruar në dëm tim E lus Gjykatën e Apelit të krahason dëshminë në prokurori me aktgjykimin. Ka cekur se i njëjti në një pjesë të procedurës ka qenë i liruar me kaucion dhe ne seancën e radhës është paraqitur pa asnjë mëdyshje kur mu ka caktuar masa e paraburgimit, nuk mka shku mendja që mos të paraqitem në gjykatë se kam qenë i bindur në pafajësinë time, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lart.

Përgjigjet në ankesë

Prokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës Kosovës në përgjigje në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit S.B, av.Dejan Vasic, ka theksuar se edhe pse mbrojtësi i të akuzuarit ka ushtruar ankese për tri baza ankimore megjithatë e tërë ankesa e mbrojtësit ka të bëjë me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe ky pretendim i mbrojtësit është i pa bazuar, pasi që gjendja faktike është vërtetuar në bazë të deklaratave të dëshmitarëve, dhe tutje i referohet deklaratave të tyre. Ka shtuar se pretendimet e mbrojtësit nuk gjejnë mbështetje në provat të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor andaj kërkoj nga gjykata që ta refuzojnë këtë pretendim të mbrojtjes. Lidhur me deklaratën e dëshmitarit M.S se e njëjta nuk është objektive dhe se i njëjti kishte arsye personale për të dëshmuar kundër të akuzuarit, ky pretendim nuk është i bazuar ngase deklarata e dëshmitarit është në përputhje me deklaratat e tjera të administruara gjatë gjyqimit. Më tej thekson se mbrojtja e të pandehurit pretendon se dëshmitari S. e kishte inat dhe për arsye personale ka deklaruar kundër të pandehurit B., e megjithatë në asnjë moment në ankesë nuk e thekson se cila është ajo arsye personale apo cilat janë ato motive të cilat mbrojtja i pretendon, a janë motivet personale të kohës kur ka ndodhë ngjarja apo janë motive personale të mëvonshme. Nga gjendja faktike dëshmohet se ngjarja ka ndodhur, se T. ishte kidnapuar nga i pandehuri, se dëshmitari e kishte shpëtuar dhe e kishte kthyer në shtëpi. Tani në gjithë këtë proces është evidente se ka mospërputhje në mes të deklaratës së viktimës dhe dëshmitarit, në sekuencat e caktuara të ngjarjes. Kjo mospërputhje është minore dhe mund të jetë rezultat i periudhës së gjatë kohore e cila ka kaluar nga koha e kryerjes së veprës penale, nga fakti se të dy dëshmitarët, e sidomos e dëmtuara T. janë të moshës së shtyer dhe kjo mund ta afektojë memorien po kjo nuk e humb rëndësinë e thelbit të dëshmisë me të cilën vërtetohet gjendja faktike.

Për sa i përket pretendimit të mbrojtjes lidhur me identifikimin e të akuzuarit, prokurori i shtetit gjatë gjithë gjyqimit asnjëherë nuk e ka fshehur faktin se e dëmtuara nuk e ka identifikuar të pandehurin përmes procesit të fotografive apo në shikim të drejtpërdrejtë gjatë mundësisë së

veçantë. Megjithatë ne kemi dëshmuar se identifikimi i tije është bërë në përputhje me procedurën e paraparë në nenin 120 të KPP-së. Të gjithë dëshmitarët e kanë identifikuar të akuzuarin përveç të dëmtuarës për faktin se kanë kaluar me shumë se 20 vite dhe hetuesit nuk kanë mundur të gjejnë foto të të akuzuarit nga periudha kohore 1998/1999 për çka u detyruan ta përdorin fotografën e viti 2021, megjithatë e dëmtuara në deklaratën e datës 18.06.2021 e përshkruan të pandehurin, duke përshkruar pjesë të deklarimeve të tyre, andaj konsideron se pretendimi i mbrojtjes lidhur me këtë rrethanë është i pasaktë, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Mbrojtësi i të akuzuarit S.B, av.Dejan Vasic, në përgjigje në ankesën e Prokurorisë Speciale ka theksuar se prokuroria është dashur që ta ndërprejë procedurën menjëherë pas deklaratës së të dëmtuarës kur e njëjta ka deklaruar se nuk e njeh të akuzuarin dhe ai nuk është personi i cili e ka marr. Arsyetimi i aktgjykimit udhëhiqet nga një dispozitiv të rrem, pasi që ajo që është cekur nuk është vërtetuar me asnjë provë por vetëm është imagjinar. Për me tepër prokurori më tutje merret me analizën e peshës së veprës penale duke thënë se sipas mendimit të Gjykatës Supreme, kjo veprë dënohet me 15 vite burgim dhe është nder veprat me të renda. Kjo nuk është e vërtet pasi që për veprat me të renda parashihet dënimi me 20 vjet burgim e me shumë, pastaj lidhur me rrethanat veçanërisht renduese prokurori ka theksuar se është dashur që të merret parasysh fakti se e dëmtuara T. është pshtetur pas murit nën kërcënimin e armës nga i dënuari, mirëpo i njëjti këtë nuk e ka dëshmuar me asnjë provë në shkresat e lëndës e cila e përshkruan dëshmitari M.S pretendon se i dënuar ka qen i armatosur, a e dëmtuara T. se ka pasur kalshnik. Pishtol megjithatë, askush nuk e përmend dhe jam i sigurt se prokurori, por edhe anëtarët e kolegjit e dinë se është një zbulim i pastër e gjykatës së shkallës së parë, prandaj është dashur që i njëjti në fjalën përfundimtare si dhe në vet aktakuzën dhe të tregoj se nga kanë ardhur këto informacione. Më tej thekson se ajo çfarë i bënë përshtypje ishin fjalët “për prokurorin e shtetit këto rrethana janë të paqarta dhe konfuze për faktin se i pandehuri ka qenë në paraburgim gjatë gjithë procedurës”. Prokurori e dinë se i dënuari nuk ka qenë krejt kohën në paraburgim duke marr parasysh se një pjesë ka qenë i liruar me kaucion, andaj nga arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit, pas analizimit të aktgjykimit të ankimuar së bashku me shkresat e lëndës, e duke vlerësuar pretendimet ankimore së bashku me përgjigjet në ankesë, ka gjetur se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni

384 të KPPRK-së, të pretenduar me ankesë të mbrojtësit e të akuzuarit dhe në ankesë e të akuzuarit edhe pse në ankesë i akuzuari nuk thekson asnjë pretendim lidhur me këtë bazë ankimore, e të cilat sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, për faktin se dispozitivi është i qartë dhe i kuptueshëm ndërsa në arsyetim janë dhënë arsyet e plota dhe të qarta për fakteve vendimtare dhe se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban asnjë shkelje tjetër të cilat kishin për të kushtëzuar anulimin e detyrueshëm të aktgjykimit të ankimuar e as që është shkelur ligji penal në dëm të të akuzuarit.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin ankimor të mbrojtësit e të akuzuarit përkitazi me shkeljen e dispozitave të nenit 370 par.7 KPPRK me të cilën thekson se gjykata e shkallës së parë këtë dispozitë e ka shpërfill plotësisht duke vendosur në pjesën e dispozitivit të aktgjykimit si fakte të vërtetuara pjesët që i kam theksuar dhe nënvizuar në pjesën hyrëse të kësaj ankese. Kjo për faktin se pjesa e dispozitivit të pretenduar dhe nënvizuar sipas ankesës së mbrojtësit e të akuzuarit, gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, si ato faktike dhe ato juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë andaj, nuk qëndron pretendimi se këtë e ka shpikur vet gjykata e shkallës së parë por ato janë vërtetuar nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor.

Kolegji i kësaj Gjykate vlerëson se Gjykata e shkallës së parë të gjitha provat e administruar në shqyrtimin gjyqësor i ka analizuar një nga një dhe pas vlerësimit të tyre, në pajtim me dispozitën e nenit 361 par.1 të KPPRK-së, ka nxjerrë përfundimin se faktet vendimtare të kësaj çështje penale janë të provuara për të cilat në arsyetim ka dhënë arsye të qarta dhe konkrete për vendin, kohën dhe mënyrën se si ka ardhur deri të kryerja e veprës penale nga i akuzuari, të cilin përfundim e aprovon edhe kjo Gjykatë si të drejt, objektiv dhe të ligjshëm.

Për më tepër, në këtë pikë të bazës ankimore i referohet pretendimit për gjendjen e fakteve që sipas mbrojtjes me asnjë provë nuk është vërtetuar se kjo ka ndodhur, ashtu siç interpretohet nga prokurori special dhe gjykata e shkallës së parë, dhe që Gjykata e Apelit të bindet për të vërteten nuk i duhet as gjysmë ore lexim, mjafton të studiohen dy thëniet e T.K në tri thëniet e M.S. Për këto pretendimet kjo Gjykatë do të paraqes në vazhdim të arsyetimit në pjesën e që i referohet vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike.

Ndërsa, përkitazi me theksimet e mbrojtësit lidhur me fjalët përfundimtare të prokurorisë dhe mbrojtjes se gjykata është selektive, arbitrare dhe injorante për atë që kemi deklaruar unë dhe

prokurori, për kolegjin e kësaj gjykata është një pretendim i përgjithësuar dhe si i tillë i pabazuar ngase gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar ka dhënë arsyet lidhur dhe vlerësimin e pretendimeve dhe tezave të ngritura nga mbrojtësi por jo se është përshkruar në mënyrë selektive apo arbitrare fjalët përfundimtare.

Për më tepër kjo Gjykatë rikujton se fjala përfundimtare e palëve në vete ngërthen qëllimin e përmbledhjes së argumenteve të tyre lidhur me rastin në fjalë ndërsa gjykata në arsyetim paraqet arsyet lidhur me vlerësimin e tyre në raport me provat e administruara për të argumentuar për pretendimet të ngritura në fjalë përfundimtare por jo si pretendon mbrojtja domosdoshmërinë e përfshirjes në tërësinë e saj në arsyetim të aktgjykimit.

Të gjeturat lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike

Sa i përket pretendimeve ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë edhe gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për faktin se me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari S.B është kryes i veprës penale për të cilën është shpallur fajtor.

Gjykata e Apelit gjen se në këtë çështje penal gjendja e fakteve nuk është vërtetuar në kundërshtim me përmbajtjen e shkresave të lëndës, procesverbalit mbi provat e shqyrtuara apo mbi dyshimin e saktësisë apo bazueshmërisë së vërtetimit të fakteve vendimtare ashtu si pretendon i akuzuari dhe mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë ngase të gjitha faktet dhe rrethanat e rëndësishme dhe vendimtare në këtë çështje penale janë vërtetuar në përputhje me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor dhe në këtë drejtim nuk ka gjetur ndonjë mospërputhje apo në kundërshtim me përmbajtjen e shkresave të lëndës për faktin se Gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar se i akuzuari S.B, në mënyrën e përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, pasi që i njëjti në periudhën kohore Korrik-Gusht të vitit 1998, në fshatin B., Komuna e Pejës, në kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë, e merr peng të dëmtuarën T.K, në atë mënyrë që ditën e incidentit, i armatosur shkon në shtëpinë e fqinjëve të tij-këtu të dëmtuarve R. dhe T.K që të dy atëherë të moshës rreth 60 vjeçare, me ç’

rast fillimisht gjuan me armë automatike në drejtim të kulmit dhe dritareve të shtëpisë të cilat i dëmton, pastaj hyn në shtëpi me pretekstin se po kontrollonte për njerëz të tjerë, më pastaj i nxjerr në oborr të dëmtuarit duke i urdhëruar që disa herë të ulen dhe të ngritën në këmbë dhe në atë moment, të dëmtuarën T. e nxjerr në rrugë, kurse të dëmtuarit R. i thotë se po e dërgonte gruan e tij në shtab të ushtrisë dhe policisë serbe në qendër të fshatit duke e paralajmëruar se mund ta merrte atë vetëm pasi t'i sillte pjesëtarët e UÇK-së dhe kështu e detyron të dëmtuarën T. që të niset nga shtëpia dhe të ecë përgjatë rrugës së fshatit në kohë nate dhe në kohë lufte në një zonë jo shumë të banuar dhe pa ndriçim ashtu që e dërgon deri tek qendra e fshatit ku ndalet tek shitorja dhe në prezencë të shumë personave tjerë e mbështetë për muri kurse vet me armë në dorë i rri përballë në distancë shumë të afërt e në ndërkohë vie fqinji i të dëmtuarës, dëshmitari M.S i cili përleshet me të pandehurin duke e goditur me grusht me ç' rast arrin të dëmtuarën ta kthejë në shtëpinë e saj kurse të nesërmen i merr dy të dëmtuarit (R. dhe T.) i largon nga fshati B. duke ua krijuar mundësinë që të shkojnë në qytetin e Pejës.

Deri të kjo gjendje faktike, gjykata e shkallës së parë kishte ardhur pas administrimit provave duke dëgjuar dëshmitarë dhe me pajtimin e palëve janë lexuar provat materiale si deklarata e të dëmtuarës T.K e dhënë në seancën dëgjimore të mundësisë hetuese të veçantë, Raporti i shpejtë me numër 2020-SHKL-815 i datës 22.12.2020; Raporti i oficerit të policisë K.K i datës 22.12.2020; Procesverbali mbi identifikimin e personit përmes fotografisë i datës 22.12.2020, i dëshmitarit S.Ç; Procesverbali për identifikimin e personit përmes fotografisë, i datës 22.12.2020, i dëshmitarit M.S; Procesverbali për identifikimin e personit përmes fotografive i datës: 18.06.2021, e dëshmitares të dëmtuarës T.K; Shënimi zyrtar i oficerit të policisë me numër 202-DKR-33, i datës 15.03.2021; Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes nga ana e teknikës kriminalistike me numër 2021-DKT-031 VN i datës 24.06.2021; Është bërë vështrim në foto albumin e vendit të ngjarjes me numër 2021:DTK-031 VN i datës 24.06.2021; Është shikuar DVD – përshkrimi i vendit të ngjarjes, si dhe deklarata e të akuzuarit S.B e datës 22.12.2020, deklarata e dëshmitarit S.Ç e dhënë në polici me datën 22.12.2020, deklarata e dëshmitarit M.S e dhënë në polici me datën: 22.12.2020, deklarata e dëshmitarit L.B e dhënë në polici me datën 23.12.2020, deklarata e dëshmitares M.Gj e dhënë në polici me datë 03.02.2021, deklarata e dëshmitares Z.B e dhënë në polici me datë 20.01.2021, deklarata e dëshmitares T.K e datës 18.06.2021, deklarata e dëshmitarit H.K e dhënë në polici me datën 23.05.2021, deklarata e dëshmitarit B.Sh, e dhënë në polici me datë 20.05.2021.

Gjykata e Apelit gjen si të pabazuar pretendimin ankimor përkitazi me atë se sipas mbrojtësit i akuzuari i është drejtuar asaj, të dëmtuarës, duke thënë se “njeriu që të ka shpëtuar është babai im L.”, dhe me këtë pyetje, i akuzuari S. ka dashur vetëm të rifreskojë kujtesën e dëshmitares se nuk ka qenë dëshmitari M.S që e ka shpëtuar atë nga një rrëmbyes i panjohur, por se atë e ka bërë babai i të dyshuarit, i ndjeri L.B.

Ky pretendim sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk është vërtetuar nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, dhe si i tillë për këtë fakt nuk është se ka deklaruar kështu e dëmtuara por këtë e thekson vet i akuzuari, e kjo vërtetohet edhe nga dëshmia e të dëmtuarës T.K, të dhënë në procesverbalin e marrjes në pyetje të datës 18.06.2021 (nr. rasti policor 2020-DKR-033), pranë së cilës deklaratë mbeti në tërësi edhe në seancën e dëgjimit mbi hetuesin e veçantë, PPPS.nr.45/20 të datës 16.07.2021, ku ndër të tjera, vërtetohet se lidhur me këtë fakt të pretenduar nga i akuzuari, në pyetjen e mbrojtësit e të akuzuarit; A ju kujtohet L.B-L?, fq.7, e dëmtuara është përgjigjur; Jo spo më kujtohet. Ndërsa në pyetjen pasuese; A të kujtohet gruaja e L.-M.?, e dëmtuara është përgjigjur; Jo nuk më kujtohet as kjo M., mu më kujtohet R. se dike kapak shqip.

Në anën tjetër Prokuroria në përgjigjen në ankesën e mbrojtësit e të akuzuarit, për të cilën gjykata gjen se është e qëndrueshme rezulton se edhe prokuroria ka theksuar se gjatë gjykimit asnjëherë nuk e ka fshehur faktin se e dëmtuara nuk e ka identifikuar të pandehurin përmes procesit të fotografive apo në shikim të drejtpërdrejtë gjatë mundësisë së veçantë.

Për sa i përket pretendimit të mbrojtjes në ankesë se i dëmtuari dhe dëshmitari M.S kinse kanë thënë se B. ka qenë ai që është hajdut, nga kjo deklaratë është e paqartë se si mund të thotë prokurori se fakti i prezencës së të akuzuarit S.B është vërtetuar në bazë të asaj që dëshmitari M.S i ka thënë se ai ishte hajdut, ndërsa e dëmtuara ka deklaruar se ishte njëfarë B. dhe se flitej se ai ishte hajdut, një përfundim i tillë është në kundërshtim nga parimi in dobi pro reo, i përfshirë në nenin 2. KPRK-së, pasi që fakti që një person është hajdut mund të provohet vetëm dhe ekskluzivisht me një aktgjykim të formës së prerë, ky pretendim sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate është i pabazuar ngase nga këto dy dëshmi, pra të dëmtuarës dhe dëshmitarit S., rezulton përshkrimi i njohurisë të këtyre dëshmitarëve për të akuzuarin për atë periudhë kohore për nga mënyra e sjelljes së tij në shoqëri dhe rrethi ku ai jetonte se si e ka njohur apo konsideruar atë në atë kohë rrethi i njerëzve që atë e njihnin por jo se me këtë do të vërtetonin ndonjë rast konkretë penal si pretendon mbrojtja.

Përkitazi me pretendimin e mbrojtjes se prokurori në fjalën përfundimtare thekson se i dëmtuari gjatë procesit të identifikimit nuk ka mundur ta njohë të dënuarin S. në fotografi, me sa duket janë fotografi të reja dhe jo të kohës kur ka ndodhur ngjarja para 20 viteve, lidhur me këtë prokurori i shmanget faktit se e dëmtuara, znj. T. ka deklaruar para trupit gjykues në një rast të veçantë provash më 16.07.2021, kur e ka parë S. drejtpërdrejt para gjykatës se nuk është ky personi që e mori nga burri i saj Rexhepi dhe se ajo nuk e njeh fare S., lidhur me këtë pretendim, në përgjigjen në ankesën e mbrojtësit e të akuzuarit edhe prokuroria, për të cilën gjykata gjen se është e qëndrueshme, rezulton se edhe prokuroria ka theksuar se gjatë gjykimit asnjëherë nuk e ka fshehur faktin se e dëmtuara nuk e ka identifikuar të pandehurin përmes procesit të fotografive apo në shikim të drejtpërdrejtë gjatë mundësisë së veçantë, dhe për këtë ka konsideruar faktin e kalimit të kohës nga kryerja e veprës penale deri në kohën kur është dëgjuar në cilësinë e të dëmtuarës dhe faktin e mos posedimit të ndonjë fotografie me pamjen e tij nga periudha e kohës së krimit.

Gjykata e Apelit lidhur me këtë fakt të sipër pretenduar nga mbrojtja gjen të pabazuar ngase edhe gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, fq.23, ka dhënë arsyet e qarta se është e natyrshme duke marrë parasysh moshën e të dëmtuarës dhe kohën e kaluar mbi 20 vjet nga ngjarja e ditës kritike që nuk ka mund të identifikoj të dëmtuarin mirëpo, gjykata nuk është mbështetur vetëm në këtë dëshmi lidhur me këtë fakt, por në ndërlidhshmerinë edhe me provat tjera të administruara në shqyrtim gjyqësor, për të cilën vlerësim pajtohet dhe kjo Gjykata si të drejtë dhe të bazuar në provat e administruara në shqyrtim gjyqësor dhe se çështja e identifikimit të akuzuarit si kryes i veprës penale është vërtetuar nga dëgjimi jo vetëm të dëmtuarës T. por edhe me dëshminë e dëshmitarëve tjerë të dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor.

Sa i përket pretendimit së mbrojtës se për dëshmitarin M.S, prokurori special ka thënë se i beson atij pasi ai nuk ka motive personale për të akuzuarin S., ndërsa se kushdo që ka qenë në sallën e gjyqit gjatë marrjes në pyetje të këtij dëshmitari ka parë se sa urrejtje personale kishte ky dëshmitar ndaj personit të dënuar, në fund të fundit, kjo është shënuar në procesverbal kur ai i është drejtuar të dënuarit me fjalët se njerëzit si ai duhet të vriten, kurse lidhur me besueshmërinë e dëshmitarëve nuk është marrë as prokurori e as gjykata, kolegji i kësaj gjykate vlerëson si të pabazuar, ngase edhe prokuroria në përgjigjen në ankesë për sa i përket këtij fakti ka theksuar se në asnjë moment në ankesë nuk e thekson se cila është ajo arsye personale apo cilat janë ato motive të cilat mbrojtja i pretendon, a janë motivet personale të kohës kur ka ndodhë ngjarja apo

janë motive personale të mëvonshme ndërsa në anën tjetër rezulton se gjykata e shkallë së parë në arsyetim e aktgjykimit gjatë analizimit të dëshmive ka vlerësuar se dëshmitë ishin të sakta, të hollësishme dhe plotësonin njëra-tjetrën dhe të tilla për gjykatën ishin tepër bindëse, pra për gjykatën e shkallës së parë pa përjashtim të gjithë dëshmitarët ishin të besueshëm andaj në këtë drejtim rezulton se ky pretendim është i pabazuar ngase për këtë gjykata e shkallës së parë kishte dhënë arsyet përkitazi me besueshmërinë e dëshmitarit.

Kjo Gjykatë për sa i përket pretendimit të mbrojtjes, ku është shënuar në procesverbal kur ai i është drejtuar të dënuarit me fjalët **se njerëzit si ai duhet të vriten**, vëren se nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 12.07.22, lidhur me këtë pyetje të parashtruar nga mbrojtësi, citim; mbrojtësi thekson se unë këtë pyetje e parashtroj sepse në deklaratën e dhënë në prokurori me dt.14.03.2021 në pyetjen e avokatit në përgjigjen e tretë nga fundi, dëshmitari është përgjigjur “unë personat e tillë si ju, do t’i pushkatoja”, dëshmitari është përgjigjur; “Ai parafrazoj”. Ndërsa nga shqimi në deklaratën e dëshmitarit M.S, të dhënë në Prokurori, PPS.nr.108/2020, dt.04 mars 2021, fq.7, përkitazi me pyetjen e lartë cituar, pasuesi 11, rezulton se dëshmitari është përgjigjur, citim; Unë nuk dua të gënjej, prapë po e përsërisë për shkak të këtyre gënjeshtreve që e nervozojnë dhe e dëmtojnë familjen time që është e pastër dhe të cilët mendojnë të shkaktojnë dëm edhe të tjerëve, të tillëve duhet tu u kundërvihesh edhe me çmimin e pushkatimit”, pra në rrethanat e këtilla rezulton se ai këtë pohim e ka vlerësuar si parafrazim dhe jo si pretendon mbrojtja për lloj të urrejtjes ndaj të akuzuarit për këtë çështje penale.

Megjithatë Kolegji i kësaj gjykate, vëren se nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 12.07.22, rezulton se dëshmitari shprehje kundërshtuese për situatën e ditës kritike e kishte manifestuar edhe në ditën e ngjarjes, pra të shprehurit e tij nuk janë vetëm në shqyrtim gjyqësor, ku ai kishte përshkruar rastin e ditës kritike, ku në mes tjerash ka theksuar; *Para se të nisemi i jam drejtuar të pranishmëve që nëse përsëritet kjo edhe njëherë do të më përgjigjen mua, nuk guxon asnjë familje shqiptare, boshnjake apo rome kjo të mendohet e jo të ndodhë”*.

Në rrethanat e këtilla për sa i përket kredibiliteti të dëshmitarit të pretenduar sipas mbrojtjes, për kolegjin e kësaj gjykate rrjedh se ky dëshmitarë, përkundër që kishte theksuar për ngjarjet e tjera në raport me të akuzuarin, për rrethanat e dëshmuara për ditën kritike në raport me të dëmtuarën, nuk rezulton se është jokredibil, ngase përshkrimi i ngjarjen e cila i kishte ndodhur të dëmtuarës T.K, e të cilën ngjarje-rrëmbim të ditës kritike në mënyrë të njëjtë e ka përshkruar dhe vet e dëmtuara, edhe pse nuk e identifikon të akuzuarin gjatë kësaj procedure penale, duke përshkruar

më tej dëshmitari mënyrën dhe vendin se si e kishte gjetur ditën kritike të dëmtuarën kur e kishte marrë nga i pandehuri, të cilin edhe e kishte grushtuar, andaj edhe mënyra e të shprehurit tij, sipas bindjes së kësaj gjykate, rezulton se janë në shenjë të kundërshtimit të personave si thekson ai në deklaratën e tij, citim;” të tillëve duhet tu u kundërvihesh edhe me çmimin e pushkatimit”, se u drejtohet njerëzve të tillë duke shprehur edhe çmimin për tu kundërvënë personave të tillë por jo domosdoshmërisht të kuptuarit se i drejtohet ekskluzivisht të akuzuarit vetëm për këtë rast penal.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin e mbrojtësit se dy dëshmitarët S.Ç dhe M.S kanë paraqitur falsifikime të rënda para gjykatës, dhe në fjalën përmbyllëse i referohet në detajet e mosmarrëveshjet në deklaratat e këtyre dy dëshmitarëve e që i kam vënë në kontrast me deklaratën e të dëmtuarës T.K e cila është e vetmja që mund t'i besohet me siguri 100%, kurse për mendjen e kthjellët të zonjës T. ka dëshmuar djali i saj H.K, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në arsyetim ka dhënë arsyet për secilin dëshmi për të cilën i ka falur besimin e nga të cilat ka ardhur në përfundim për vërtetimin e gjendjes se faktike e për të cilën pajtohet edhe kjo gjykatë ngase nga këto provat është vërtetuar gjendja e fakteve të përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit i cili është dhe në përputhje me arsyet e dhëna në arsyetimi e aktgjykimit të ankimuar.

Është i pabazuar pretendimi ankimor ku mbrojtja i referohet këtyre mosmarrëveshjeve, duke përshkruar ngjarjen që zonja T. në thelb thotë: Se nuk i ka dëgjuar të shtënat, para shtëpisë se tyre dhe pastaj se në shtëpinë e tyre ka hyrë një person ku kanë qenë ajo T. dhe R. duke kërkuar refugjat, ku pse me arme në dorë e ka nxjerrë T. nga shtëpia dhe e ka qu deri te shitorja, atje një person tjetër (djemtë e B.) e kanë ndalura dhe pas bisedës mes mese veti T. e kanë kthye në shtëpi. Kjo për faktin se e dëmtuar në deklarinimin e saj të dhënë në polici më dt.18.06.2021, fq.3, në përgjigjen e fundin të kësaj faqe, pos tjerash ka dëshmuar duke përshkruar, citim;” Na rrishim shlir kur prej rrugës dikush ka gjuajt 3 herë mbi shpin ton dhe kur ka dal te qoshi i shpis ka gjuajtur 2 herë te cepi i shpis dhe ka gjuajt si anash veç me na tut, atëherë hini mbrena në oborr ishte vetëm, dhe tha çka keni mrena qitini jashtë...”. Ndërsa në procesverbalin e seancës së dëgjimit mbi hetuesin e veçantë, të datës 16.07.2021, ajo konfirmoj se qëndron pranë asaj deklaratë të dt.18.06.2021, sikur kam thënë në Pejë, nuk kam harruar, çka kamë thënë atëherë nuk ka diçka tjetër për të shtuar, duke e përsëritur më tej prapë momentin e gjuajtjes me armë të ditës kritike gjatë përgjigjes së dhënë në pyetjen e të pandehurit andaj në këtë drejtim rezulton

se ky pretendim ankimor është i pabazuar nga fakti se edhe e dëmtuara T. konfirmon faktin se në ditën kritike ka pasur gjuajtje të armës para se të hynte ky person në oborrin e shtëpisë së tyre.

Ndërsa dëshmitari M.S, në deklaratën e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor lidhur me këtë fakt, në pyetjen e mbrojtësit; shtëpia e juaj dhe shtëpia e familjes K. , diku 50 metra distancë, a janë dëgjuar para se të ndodh kjo, a janë dëgju krismat?, dëshmitari është përgjigjur; Jo nuk kam dëgjuar. Andaj, nga këto nuk rrjedh se ka mospërputhje mes këtyre dëshmimeve si pretendon mbrojtja ngase ata kanë deklaruar atë çka kanë dëgjuar por jo se janë në kundërshtim këto deklaramet.

Gjykata e Apelit për sa i pretendimin ankimor të mbrojtësit përkitazi me dy deklaratat e dëshmitarit S.Ç, i cila thotë se gjithçka që thotë e ka dëgjuar nga M.S, ndërsa M.S gjatë gjykimit pretendon se nuk ka folur fare me S.Ç për ngjarjen. Kjo për faktin se lidhur me këtë dëshmitari për këto fakte në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor kishte dhënë sqarimet duke theksuar “Më ka ardh keq për S.Ç kur kam ndëgju që unë e kam shpionu atë, e unë kurrë nuk e kam parë, unë atëherë S.Ç i kam thanë “mos i qitin fjalët që unë kam qenë ai që e kam parë dhe kam shku në polici e ka lajmëru, sepse unë nuk kam kurrfarë lidhe me asgjë përveç këtij rasti që jeni këtu”, dhe në pyetjen pasuese dëshmitari ka sqaruar se; kur kemi shku në polici, ai ka shku i pari, pastaj kanë ardh tek unë në ora 19:00, dhe për shkak të kësaj më ka ardh inati dhe i kam thën S. mos më përziej me këtë, kurse këto deklarata që ka deklaruar S. janë që i ka dëgju nga familja K., sepse unë kurrë nuk i kam thënë asgjë përveç kur gjykatës se çka ka ndodhur gjën se edhe përkundër kësaj dëshmitari S.Ç është një prej dëshmitarëve që kishte dëshmuar për ngjarjen për të cilën kishte dëgjuar edhe prej dëshmitarëve tjerë ku mes tjerash ai kishte dëgjuar për këtë ngjarje edhe nga i ndjeri R., prandaj dëshmia e tij nuk është se është në kundërshtim me ngjarjen e dëshmuar në raport me atë çka ka dëshmuar dëshmitari M.S.

Gjykata e Apelit gjën të pabazuar pretendimin e mbrojtësit e të akuzuarit se gjykata e shkallës së parë provat kryesore për veprimet inkriminuese të të akuzuarit i ka vërtetuar nga personat e lënduar, gjegjësisht dëshmitarja T.K si palë e dëmtuar dhe deklaratat e M.S si dëshmitar i cili ka qenë drejtpërdrejtë i përfshirë në ngjarjen e ditës kritike)... e lënduar T.K të cilën nuk ka mundur ta identifikojë përmes fotos, por trupi gjykues vlerëson se është edhe e natyrshme, duke marrë parasysh se kanë kaluar 20 vjet nga ngjarja dhe moshën e të dëmtuarit..., mirëpo në rastin e citimit të deklaratës së palës së dëmtuar, gjykata shmangu të shkruante se ajo e tha qartë në seancë për një mundësi të veçantë provash pasi e kishte parë S. drejtpërdrejt.- se ai nuk e nje

atë dhe se nuk është ai personi që e ka marrë nga shtëpia. Kjo për faktin se gjykata e shkallë së parë në aktgjykimin e ankimuar ka dhënë arsyet e qarta se lidhur me identifikimin e të akuzuarit si kryerës i veprës penale për të cilën e ka shpallur fajtor ajo e ka vërtetuar edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve tjerë të administruara në shqyrtimin gjyqësor.

Për më tepër kolegji i kësaj gjykate vlerëson se edhe pse e dëmtuara nuk ishte në gjendje që ta identifikonte drejtpërdrejtë të akuzuarin, me gjithë atë ajo në deklaratën e saj e ka përshkruar personin i cili e kishte marr peng në shtëpinë e saj, duke precizuar se i cilës familje ishte, ku ajo i referohet “ ai i B. u kon ma i lazdrum veç kur skem pas probleme e qat nat pi ka ardh me Automat”, çfarë sjelljesh kishte në atë kohë në rrethin ku jetonte, duke i referuar “i thojshin i B. edhe krejt i thojshin hajn kur folshin për to” dhe se kur ishte kthyer në shtëpi, është fjala për ditën kritike, R. tha na tuti se ton e keshi B. i thojnë Hajn e gjithçka e tha ato e ka qu dikush, se R. nuk u kon dallavergji, Ato ka mujt me qu dikush se aty rrishin tu pi te shitorja. Andaj, marrë parasysh këtë deklaratë të dëmtuarës si objektive dhe të drejtë dhe duke e ndërlidhur me deklaratën e dëshmitarit M.S e cila edhe përkundër disa rrethanave të cilat i kishte sqaruar gjatë shqyrtimit gjyqësor lidhur me atë se nga kush kishte kuptuar kur ishte marrë peng e dëmtuara natën kritike dhe nga provat tjera personale dhe material të administruara në shqyrtim gjyqësor, me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se i akuzuari S.B, e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, për të cilën edhe kjo Gjykatë pajtohet me përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se në këtë çështje penale me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar ndërsa pretendimet e të akuzuarit S.B dhe mbrojtësit të tij av.Dejan Savic, për arsyet e lartcekura janë refuzuar si të pabazuar.

Të gjeturat lidhur me shkeljet e ligjit penal

Edhe pse në ankesë i akuzuari dhe mbrojtësi i tij nuk theksojnë konkretisht lidhur me çështjen për shkeljen e ligjit penal, në përjashtim se janë thirre në këtë bazë ankimore, megjithatë Gjykata e Apelit gjen se në këtë çështje penale nuk ka shkelje të ligjit penal. Kjo për faktin se në gjendjen faktike të provuar nga provat e administruara në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë elementet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari ngase i njëjti është penalisht përgjegjës ndërsa në anën tjetër nuk ekziston asnjë nga rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale e të akuzuarit.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, fq.25, ka dhënë arsyet e vlerësimit dhe zbatimit të ligjit material për veprimet inkriminuese e të akuzuarit duke qenë se është vërtetuar se i akuzuari veprimet inkriminuese i kishte ndërmarrë në kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë, Korrik-Gusht 1998, të drejtuara ndaj viktimave që ishin civilë, e të cilët nuk kanë marrë pjesë në luftimet që ishin duke u zhvilluar në atë kohë dhe pikërisht marrjen peng e të dëmtuarës, e që në situatë të tillë viktimat gëzojnë mbrojtjen nga neni 3 i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949, për të cilën arsyet pajtohet dhe kjo Gjykatë si të drejta dhe ligjor ngase në veprimet e të akuzuarit fitohen elemente e veprës penale Krime lufte kundër popullatës civile nga neni 142 të LP të RSFJ-së, si ligj në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, aktualisht e ndëshkueshme sipas veprës penale Krime lufte në shkelje të rëndë të nenit 3 par. 1 shkronja/b/ dhe /c/ të përbashkët për Konventat e Gjenevës, të dt. 13 gusht 1949 dhe nenit 4 par. 2 shkronja /c/ dhe /e/ të Protokollit II, aktualisht i ndëshkueshëm edhe nga neni 146 të KPRK-së (Nr.06/L-074), meqenëse është vërtetuar se i akuzuari veprimet i kishte ndërmarrë në kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë, Korrik-Gusht të vitit 1998, ku i akuzuari në ditën kritike pasi fillimisht gjuan me armë automatike, më pas e marrë peng të dëmtuarën, ndërsa të dëmtuarit R. i thotë se po e dërgonte gruan e tij në shtab të ushtrisë dhe policisë serbe në qendër të fshatit duke e paralajmëruar se mund ta merrte atë vetëm pasi t'i sillte pjesëtarët e UÇK-së, ku e detyronte të njëjtën të ecë përgjatë rrugës së fshatit në kohë nate dhe në kohë lufte në një zonë jo shumë të banuar dhe pa ndriçim, ashtu që e dërgon deri tek qendra e fshatit ku ndalet tek shitorja dhe në prezencë të shumë personave tjerë e mbështet për muri, gjë që me këtë veprim pa dyshim vërtetohet se ishin të drejtuara ndaj të dëmtuarve civilë të nacionaliteti shqiptar, duke vendosur kushtin bashkëshortit të dëmtuarës, R., se do ta merrte gruan e tij në rast se i sillte ushtarët e UÇK-së, gjë që rrjedh se i akuzuari veprimin e tij e kishte të motivuar dhe ndërmarrë për rrethanat dhe në lidhshmëri me konfliktin e armatosur në atë kohë dhe vend ku kishte ndërmarrë veprim inkriminues.

Të gjeturat për vendimin mbi dënimin

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e prokurorisë për një dënim me të ashpër nuk janë të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka marrë parasysh dhe ka vlerësuar drejt të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit konform nenit 64 të KPK-së. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese rrethanat personale të akuzuarit si: qëndrimi korrekt në gjykatore, mbajtja e premtimit se do të

paraqitet në gjykate sa here që gjykata e fton si dhe se gjykatës nuk i janë ofruar prova që i njëjti më parë ka ra ndesh me ligjin, ndërsa si rrethana renduese ka vlerësuar rrethanat të renda në të cilat është kryer vepra penale si dhe pesha shume e rende e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale e të akuzuarit, e cila është shumë e lartë, vepra është kryer me dashje direkte, paramendim, motivet e kryerjes së veprës penale, pasojat shumë të mëdha të shkaktuara nga veprat penale në gjendjen e të dëmtuarave që është manifestuar me një shqetësim dhe traumë (siç e ka përshkruar vajza e tyre Z.) dhe frikën e tyre se çka mund të ju ndodhë më pastaj përkatësisht çfarë do të jenë pasojat nga këto veprime e të akuzuarit, andaj duke marrë parasysh të gjitha këto rrethanat të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimi se në dënimin e shqiptuar nuk janë vlerësuar rrethanat renduese siç janë shkalla e lartë e rrezikshmërisë se veprës penale, pasi që i akuzuari kishte hyrë i armatosur në shtëpinë e të dëmtuarve, faktin se viktimat ishin në moshë të shtyrë dhe posaçërisht të pa mbrojtur, motivin e ulët për të pashtuar të dëmtuarën T.K duke e detyruar të qëndroj mbështetur për muri tek shitorja në qendër të fshatit nën kërcënimin e armës, sipas vlerësimit të kësaj gjykate janë pretendime të pa bazuara për faktin se rrethanat në të cilat thirret prokuroria kanë qenë objekt vlerësimi nga gjykata e shkallës së parë, janë peshuar në mënyrën e duhur, si të tilla nuk kanë ndikim që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim tjetër nga ai i cilin është shqiptuar.

Ndërsa pretendimin e mbrojtësit e të akuzuari në përgjigjen në ankesë të PSRK-së, lidhur me rrethanat veçanërisht renduese ku prokurori ka theksuar se është dashur që të merret parasysh fakti se e dëmtuara T. është pshtetur pas murit nën kërcënimin e armës nga i dënuari, mirëpo i njëjti këtë nuk e ka dëshmuar me asnjë provë në shkresat e lëndës, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate këto pretendime janë trajtuar në kuadër të gjendjes së fakteve ndërsa gjykata e shkallës së parë të njëjtat i ka pasur parasysh gjatë shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit andaj edhe kjo gjykatë ka bindjen se në rrethanat e tilla të vlerësuar drejt japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit sipas nenin 33 të LPRSFJ-së, që në të ardhmen të akuzuarin ta parandaloj nga kryerja e veprave penale dhe si preventiv gjenerale për ti përmbajtur personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga arsyet e sipër cekura dhe në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
DEPARTAMENTI SPECIAL
APS.nr.49/2022, datë 19.01.2023

Bashkëpunëtorja Profesionale,

Anëtarët e kolegjit,

Kryetar i kolegjit,

Syzana Goxhuli

Vaton Durguti

Burim Ademi

Ferit Osmani